



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

28 qershor 2012, Prizren

## REAGIM

### Thirrje për mosbindje qytetare

Vendimi i djeshëm i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit është përmbyllje e ciklit të absurditetit politik. EC Ma Ndryshe shpreh keqardhjen për dhunimin e demokracisë deri në instancën e Gjykatës Kushtetuese, pas një procesi disa-vjeçar, ku ishin të përfshirë edhe Qeveria, Kuvendi i Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare. Mendojmë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka defekte serioze, pasi që trajton vetëm sipërfaqësisht çështjen themelore kontestuese, shkeljen e parimit kushtetues të laicitetit. Gjykata hedhë poshtë shkeljen e hapur të kushtetutës përmes argumenteve gjysmake dhe interpretimeve të gabuara kushtetuese.

Për më tepër, është për t'u ardhur keq kur shihet se pothuaj i tërë teksti i këtij vendimi është në përputhje të plotë me opinionin që Kisha Ortodokse Serbe ia ka dhënë Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Ndërsa ky rast na dëshmon edhe një herë se institucionet e Kosovës janë të plotësisht të paafta të veprojnë me integritet dhe të pavarur nga presioni ndërkombëtar. Është tejet e dhimbshme kur gjykatësit e Kushtetueses janë të paafte të bëjnë dallimin mes konsultimit dhe vendimmarrjes efektive, kur e interpretojnë prezencën e klerikëve fetarë në një institucion publik. Për më tepër, kur diskriminimin e të tjerëve në raport me Kishën Ortodokse Serbe, që paraqet shkelje të kushtetutës, e interpretojnë si trajtim të veçantë të një komuniteti pakicë brenda karakterit multi-etnik të shtetit të Kosovës.

EC Ma Ndryshe ka qenë prijëse e kundërshtive të shumta qytetare ndaj një ligji që e konsiderojmë kundërkushtetues, diskriminues dhe të dëmshëm për qytetin e Prizrenit. Edhe pse kemi arritur në momentin kur të gjitha mjetet institucionale të kundërshtimit janë shterur, ne ende besojmë në fuqinë dhe arsyen e organizimit dhe mobilizimit qytetar. Si mjet të fundit demokratik, mosbindjen qytetare e shohim si opsionin e vetëm që mund të parandalojë të keqen që i kanoset qytetit. Për këtë arsye, i ftojmë të gjitha institucionet dhe sektorët që me ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit parashihet të përfaqësohen në komitetin komunal, të mos i dërgojnë përfaqësuesit e tyre. Përmes këtij veprimi, Bashkësia Islame, Kisha Katolike, komuniteti i ekspertëve dhe shoqëria civile mund të parandalojnë zbatimin e këtij ligji diskriminues dhe të dëmshëm për Prizrenin. Në të njëjtën kohë, i apelojmë të gjithë qytetarëve të Prizrenit që me mundësitë dhe forcat e tyre të mobilizohen dhe të jenë të gatshëm për të parandaluar çdo efekt negativ që del nga zbatimi eventual i këtij ligji.

Ne besojmë që, atëherë kur edhe Gjykata Kushtetuese bëhet shkelëse e Kushtetutës, instanca e fundit korrigjuese mbetet gjykata dhe drejtësia e qytetarëve.

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 522 199 & +386 49 116 448